



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E DREJTËSISË
DHOMA KOMBËTARE E PËRMBARUESVE PRIVAT
SHOQËRIA PËRMBARIMORE
"STRATI BAILIFF'S SERVICE" Sh.p.k.



Adresa: Rr."Jordan Misja", P 141/1, Shk 1, Ap 7, Tiranë, Tel: 04 45 00 450, www.stratibailiff.com, info@stratibailiff.com
Cel: Gentian Strati: 0674000450; Valter Kaçupi: 0674000456; Kozeta Guri: 0674000455; Edvin Malotaj: 0674000457

Nr. 4371

Nr. 6773 Prot.

Tiranë, më 23.06.2017

Drejtuar : Qëndrës Kombëtare të Regjistrimit Tiranë
Për dijëni : Shoqërisë "Ekspres-Beton Lezhë" Sh.p.k.,
Shoqërisë "Euro Aditiv" Sh.p.k.

Lënda : *Urdhër për vendosjen e sekuestros konservative*

Në Tiranë, sot më datë 23.06.2017,

Unë **Kozeta Guri**, përbaruese gjyqësore private pranë shoqërisë përbarimore "Strati Bailiff's Service" Sh.p.k., me NIPT L21825003E, e pajisur me çertifikatë Nr. 83, Maj 2012 lëshuar nga Ministri i Drejtësisë, pasi studiova materialet e dosjes përbarimore, në zbatim të "Urdhërit Ekzekutimit" Nr. 79/U Vendimi, datë 09.02.2017 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë,

KONSTATOVA:

Se në datë 09.06.2017 është depozituar kërkesa e palës kreditore dhe lidhur kontrata e shërbimit, pranë Shoqërisë Përbarimore "Strati Bailiff's Service" Sh.p.k., për ekzekutimin e titullit ekzekutiv Nr. 79 Vendimi, datë 09.02.2017 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë, për të cilin është lëshuar Urdhëri i Ekzekutimit Nr. 79/U Vendimi, datë 09.02.2017 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë, me palë :

Kreditor : Shoqëria "Euro Aditiv" Sh.p.k.,
Debitor : Shoqëria "Ekspres-Beton Lezhë" Sh.p.k.,
Me Objekt : *Kthim shume*

Me vendimin Nr. 79/U Akti, datë 09.02.2017 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë është vendosur :

"Lëshimin e urdhërit të ekzekutimit të Vendimit Gjyqësor Civil Nr. 47/697 Regjistri Themeltar, Nr. 79 Vendimi, datë 09.02.2017 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë.

"Miratimin e aktmarrëveshjes, datë 09.02.2017 të arritur ndërmjet palëve ndërgjyqëse, Shoqëria "Euro Aditiv" sh.p.k përfaqësuar nga Magdhalini Lena dhe Shoqëria "Eksper-Beton Lezhë"

sh.p.k., e përfaqësuar nga Av. Anila Frroku, ku palët merren vesh për pagesën e detyrimit me këste në llogarinë bankare të Shoqërisë "Euro Aditiv" sh.p.k. si më poshtë vijon:

- Deri më datën 25.03.2017 duhet të bëjë pagesën për shumën 60,680 lekë;
- Deri më datën 25.04.2017 duhet të bëjë pagesën për shumën 60,680 lekë;
- Deri më datën 25.05.2017 duhet të bëjë pagesën për shumën 60,680 lekë;
- Deri më datën 25.06.2017 duhet të bëjë pagesën për shumën 60,680 lekë;
- Deri më datën 25.07.2017 duhet të bëjë pagesën për shumën 60,680 lekë;
- Deri më datën 25.08.2017 duhet të bëjë pagesën për shumën 60,624 lekë".

Me shkresën Nr. 6212 Prot., datë 09.06.2017 debitorit i është komunikuar lajmërimi për ekzekutimin vullnetar.

Sa më sipër bazuar në 527 e vijues të K.Pr.Civile, Ligjit Nr.10031 datë 11.12.2008 "Për Shërbimin Përmbarimor Privat" dhe Udhëzimit Nr. 1240/5, datë 15.09.2009 "Për caktimin e tarifave për shërbimet e ofruara nga shërbimi përmbarimor privat"

URDHËROJ:

- 1- Qendrën Kombëtare të Regjistrimit të vendosë masën e sekuestros konservative mbi aktivet e rregjistruara pranë jush që zotëron pala debitore:
 - **Shoqëria "Ekspres-Beton Lezhë" Sh.p.k., me NIPT K58515501V** për ekzekutimin e "Urdhërit të Ekzekutimit" Nr. 79/U Akti, datë 09.02.2017 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë. Këto aktive të qëndrojnë të bllokuara deri në një urdhër të dytë.
- 2- Për veprimet apo mosveprimet tuaja, na vini në dijeni shkresërisht brenda afatit ligjor.
- 3- Personat që bëhen pengesë, do të përgjigjen sipas dispozitave të Kodit Penal dhe nenit 598 e në vijim të K.Pr.Civile.
- 4- Ky urdhër mbahet në disa kopje, dhe u njoftohet palëve të cilat kanë të drejtën e ankimit në Gjykatë brenda 5 ditëve.

Përmbaruese Gjyqësore Private

